



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

04.04.2017

**ZGJEDHJET STUDENTORE 2017 – NJOFTIM PUBLIK PËR
STUDENTËT**

Ne pajtim me Rregulloren mbi zgjedhjet e studentëve ju njoftojmë se me rastin e aplikimit OS paraqesin:

- Aplikacionin, të cilin mund ta shkarkoni në web faqen e UMIB – it në linkun Zgjedhjet 2017.
- Licencën e regjistrimit në Ministrinë e Administratës Publike.
- Statutin e OS.
- Formularin e deklaratave mbështetëse me nënshkrime. Formulari me të dhënat e studentëve që kanë mbështetur OS duhet të plotësohen edhe në formë elektronike në exell – Formularin mund ta shkarkoni nga web faqja e UMIB – it në linkun Zgjedhjet 2017.
- Përcaktimi i të adresuarit të autorizuar të OS.

Në bazë të nenit 8 pika 2 të Rregullore për zgjedhjet e studentëve përcaktohet:

“Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si “shoqatë”–“asociacion” në Ministrinë e Administratës Publike sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara, ndërsa për themelimin e organizatave të reja ato duhet të regjistrohen së paku 15 ditë para datës së zgjedhjeve“.

Aplikimin për pjesëmarrje në zgjedhje OS mund ta bëni deri me datën 07.04.2017.

Ju njoftojmë gjithashtu se listat e kandidatëve, në pajtim me rregulloren mbi zgjedhjet e studentëve, mund ti dorëzoni deri më datën 13.04.2017. Formularin për paraqitjen e kandidatëve mund ta shkarkoni në web faqen e UMIB – it në linkun Zgjedhjet 2017.

Sqarim shtesë lidhur me numrin e deklaratave mbështetëse për certifikim: OS që siguron së paku 150 nënshkrime të studentëve të UMIB, fiton të drejtën të radhitet në OS konkurrenente për zgjedhje studentore për Parlament të studenteve dhe Këshilla të studentëve të secilit nga fakultetet e UMIB – it. Për konkurrim vetëm në zgjedhjet për këshillë të studentëve në ndonjërin nga fakultetet, OS duhet të siguroj se paku 50 nënshkrime të studenteve dhe të cilët janë studentë të po atij fakulteti.



Xhelal Smakiqi

Kryesues i KQZ